



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, LEGJISLACIONIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. ____ Prot.

Patos, më ____/____/2026

SHPALLJE 1 (NJË) LOGOPED

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 111, datë 23.02.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e fondit social”, V.K.M nr. 150, datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, Udhëzuesin për Fondin Social “Për paraqitjen e kërkesave për njësitë e qeverisjes sociale” si dhe shkresa nr. 807/8 prot., datë 12.02.2024 “Njoftim për për zgjedhjen në projektin “Ngritja e Qendrës Multifunkionale për Fëmijët A.K”, V.K.B nr. 36, datë 30.04.2024 “Për miratimin e projektit “Ngritja e shërbimit për funksionimin e Qendrës Multifunkionale” dhe vlerën e bashkëfinancimit të tij dhe V.K.B nr. 13, datë 25.02.2026 “Për miratimin e projektit “Ngritja e shërbimit të logopedisë në Qendrën Multifunkionale” dhe vlerën e bashkëfinancimit të tij”, Bashkia Patos po kërkon të punësoj 1 (një) Logoped për ofrimin e shërbimit në qendër.

Përshkrimi i detyrave të punës dhe përgjegjësi:

- Si pjesë e ekipit multidisciplinar, Logopedi/Terapisti i të folurit vlerëson nevojat e fëmijës në lidhje me gjuhën dhe komunikimin si më poshtë:**
 - Vëzhgon fëmijën dhe vlerëson natyrën e çrregullimeve të komunikimit që ai paraqet.
 - Vlerëson aftësinë e fëmijës për të komunikuar.
 - Vlerëson aftësinë e të kuptuarit (verbal, 1, 2, hapa, gjeste, fotot)
 - Vlerëson problemet motorike që ndërhyjnë në vokalin e fëmijës
 - Vlerëson mënyrën e shqiptimit
 - Vlerëson gabimet sintaksore gjatë komunikimit
 - Vlerëson aftësitë e gjuhës basale të fëmijës.
 - Vlerëson mënyrën se si fëmija kryen kërkesat, përsërit fjalët, dialogun, etj.
 - Vlerëson komunikimin social dhe komunikimin jo-funksional (ekolalia).
 - Vlerëson aftësinë e fëmijës për të imituar.
- Përgatit Planin e Komunikimit për ndërhyrjen si pjesë e PEI të fëmijës në bashkëpunim me ekipin multidisciplinar dhe zbaton atë në këto fusha:**
 - Në kushtet e shqiptimit dhe korigjimin e fonemave, me zë dhe me regjistrimet

- Trajnon fëmijën të përdorë kërkesat, komandat interverbale, etj.
 - Trajnon fëmijën të kuptojë (emërtimin e objekteve, pjesëve të trupit, tiparet, etj.)
 - Trajnon fëmijën për të imituar dhe për të përdorur gjeste për të komunikuar.
 - Trajnon fëmijën për të përdorur PECS (Sistemin e komunikimit nëpërmjet ndryshimit të figurave.)
 - Kombinon trajnimin për komunikim me seancat e tjera të terapisë së zhvillimit, etj.
 - Përcakton natyrën e ndërhyrjes dhe nr. e seancave të të folurit (në mënyrë individuale dhe në grup) që fëmija ka nevojë të ndjekë në familje.
3. Bashkëpunon dhe këshillon familjen mbi teknikat që ata mund të përdorin për të ndihmuar fëmijën për të komunikuar.
 4. Mbështet prindin në mënyrë që të forcoj marrëdhënien e tyre me fëmijën dhe anëtarëve të tjerë të familjes duke ndihmuar në këtë mënyrë zhvillimin sa më të mirë të fëmijës.
 5. Së bashku me anëtarët e tjerë të ekipit kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit të anëtarëve të komunitetit, për sensibilizim kryesisht për ndryshimin e qëndrimeve përkundrejt fëmijëve me aftësi të kufizuara.
 6. Ndjek dhe raporton tek Menaxheri i caktuar realizimin e aktiviteteve sipas planit kohor.

1.1 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të dërgojë dorazi në një zarf të mbyllur në zyrën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Legjislacionit dhe Shërbimeve Mbështetëse të Bashkisë Patos, këto dokumenta:

- Dëshmi penaliteti
- C.V e përditësuar
- Fotokopje të noterizuar diplome të shoqëruar me listën e notave si dhe çertifikata trajnimesh të tjera nëse ka.
- Kopje e Liçencës për ushtrimin e profesionit të Logopedit.
- Vërtetimin që është i aftë për punë.

Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 30.03.2026.

1.2 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **31.03.2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkisë Patos do të shpall në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe në stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet për të qënë pjesë e Qendrës Multifunksionale.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e paraqitjes së tyre.

1.3 KUSHTET TEKNIKO-PROFESIONALE

- Të jetë i/e diplomuar (bachelor ose master) në Logopedi.
- Të ketë jo më pak se 1 vit eksperiencë pune në ushtrimin e profesionit të tij/saj ose praktikë pune jo më pak se 1 vit.
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi. (Preferohet që personi të ketë ndjekur trajnime kualifikuese shtesë në fushën e aftësisë së kufizuar.)

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

V.K.M nr. 111, datë 23.02.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e fondit social”.

V.K.M nr. 150, datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”.

1.5

DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në qoftë se për çdo pozicion do ketë më shumë se një kandidat që aplikojnë për procedurën e pranimi për pozicionin e Logopedit në Qendrës Multifunkionale, kandidatët do të njoftohen për të qënë pjesë e intervistës së strukturuar nga Komisioni Vlerësues i Bashkisë Patos. Intervista do të jetë më datë 08.04.2026.

DREJTOR

Irisi Xhelaj